

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikadur®-31 EF

NGJITËS STRUKTUROR EPOKSID ME 2 PËRBËRËS



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikadur®-31 EF është një ngjitës epoksid me 2 përbërës, tolerues i lagështisë, tiksotropik, strukturor i cili ngjitet mbi shumicën e materialeve të ndërtimit. ka rezistenca mekanike të larta dhe mund të përdoret gjithashtu për riparime të vogla betoni, mbushje fugash dhe izolim plasaritjesh.

PËRDORIMET

▪ Përdorim i brendshëm dhe i jashtëm
Ngjitës strukturor për ngjitjen e:

- Elemente betoni
- Gur natyror i fortë
- Qeramika, çimento me fibra
- Llaç, tulla, mure
- Çelik, hekur
- Dru
- Poliester, epoksid

Riparim dhe ngjitës për:

- Kënde dhe kulme
- Vrima dhe zgavra
- Përdorim vertikal dhe tavanor

Mbushje fugash dhe izolim plasaritjesh:

- Riparim fugash dhe plasaritjesh / riparime skajesh
- Izolim plasaritjesh statike jostrukturore

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Temperaturë aplikimi nga +10 °C deri në +30 °C
- Përzierje dhe aplikim i lehtë
- Ndërkapje e mirë mbi shumicën e materialeve të ndërtimit
- Tiksotropik: nuk varet në aplikime vertikale dhe horizontale
- Ngurtësim pa tkurrje
- Përbërës me ngjyra të ndryshme (për kontroll gjatë përzierjes)
- Nuk nevojitet prajmer
- Rezistencë ndaj abrazionit
- I papërshkueshëm nga lëngjet dhe avujt e ujit
- Rezistencë kimike

MIRATIME / STANDARDE

- Markë CE dhe Deklaratë Performance sipas EN 1504-4 - Ngjitje strukturore

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Rrëshirë epokside dhe lëndë mbushëse të përzgjedhura	
Ambalazhi	Përbërësit (A+B)	set 1,2 kg
	Përbërësit (A+B)	set 6 kg
	Përbërësit (A+B)	set 18 kg
Ngjyra	Përbërësi A	e bardhë
	Përbërësi B	gri e errët
	Përbërësit A+B të përzierë	gri betoni

Fleta e të dhënave të produktit

Sikadur®-31 EF

Korrik 2020, Botimi 02.01

020204030010000144

Jetëgjatësia	24 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të pahapur në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor. Lexoni gjithmonë ambalazhin.
Dendësia	Rrëshira e përzierë ~1,95 ±0,1 kg/l Vlera në +23 °C.
Deklarata e produktit	EN 1504-4: Ngjitje strukturore

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	Koha e tharjes	Temperatura e tharjes			(ASTM D 695)
		+10 °C	+23 °C	+30 °C	
	1 ditë	~15 N/mm ²	~29 N/mm ²	~34 N/mm ²	
	3 ditë	~30 N/mm ²	~39 N/mm ²	~46 N/mm ²	
	7 ditë	~38 N/mm ²	~47 N/mm ²	~51 N/mm ²	
14 ditë	~45 N/mm ²	~53 N/mm ²	~55 N/mm ²		
Moduli i elasticitetit në ngjeshje	~6500 N/mm ² (14 ditë në +23 °C)			(ASTM D 965)	
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	Koha e tharjes	Temperatura e tharjes			(DIN ISO 178)
		+10 °C	+23 °C	+30 °C	
	1 ditë	~6 N/mm ²	~10 N/mm ²	~20 N/mm ²	
	3 ditë	~20 N/mm ²	~21 N/mm ²	~26 N/mm ²	
	7 ditë	~25 N/mm ²	~28 N/mm ²	~29 N/mm ²	
14 ditë	~30 N/mm ²	~32 N/mm ²	~30 N/mm ²		
Moduli i elasticitetit në përkulje	~7700 N/mm ² (14 ditë në +23 °C)			(EN ISO 178)	
Rezistenca ndaj tërheqjes	Koha e tharjes	Temperatura e tharjes			(ISO 527)
		+10 °C	+23 °C	+30 °C	
	1 ditë	~7 N/mm ²	~10 N/mm ²	~11 N/mm ²	
	3 ditë	~18 N/mm ²	~20 N/mm ²	~24 N/mm ²	
	7 ditë	~21 N/mm ²	~22 N/mm ²	~25 N/mm ²	
14 ditë	~24 N/mm ²	~24 N/mm ²	~29 N/mm ²		
Moduli i elasticitetit në tërheqje	~6900 N/mm ² (14 ditë në +23 °C)			(ISO 527)	
Zgjatimi deri në thyerje	0,3 ± 0,1 % (7 ditë në +23 °C)			(ISO 527)	
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	Koha e tharjes	Nënshtresa	Temperatura e tharjes		(EN ISO 4624, EN 1542, EN 12188)
			+10 °C	+25 °C	
	1 ditë	Beton i thatë	>3 N/mm ² *	–	
	1 ditë	Beton i lagësht	>3 N/mm ² *	–	
	7 ditë	Çelik	–	~18 N/mm ²	
*100 % dështim betoni					
Tkurrja	Ngurtësim pa tkurrje				
Koeficienti i zgjerimit termik	4,6 × 10 ⁻⁵ (përhapje lineare ndërmjet -20 °C dhe +40 °C)			(EN 1770)	
Rezistenca kimike	Rezistencë ndaj shumë kimikatesh. Kontaktoni shërbimin teknik për më shumë informacione.				

Temperatura e shformimit termoplastik	Koha e tharjes	Temperatura e tharjes	HDT	(ASTM D 648)
	7 ditë	+23 °C	+53 °C	

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	Përbërësi A : Përbërësi B = 3 : 1 për peshë ose vëllim		
Konsumimi	~1,95 kg/m ² për mm trashësie Kjo është vlerë teorike dhe nuk përlogarit asnjë material shtesë për shkak të porozitetit të sipërfaqes, profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel apo firon, etj.		
Trashësia e shtresës	30 mm max. Për ngjitës jostrukturor apo aplikime të tjera, nëse kërkohen trashësia shtresash >30 mm, aplikoni në vijim shtresa 30 mm ose sapo të jetë ngurtësuar shtresa e mëparshme. Sipërfaqja e shtresave të ndërmjetme të sapoaplikuara duhet të ashpërsohet për të formuar një kapje për shtresat vijuese. Nëse aplikimi i shtresës do të jetë më i gjatë se 2 ditë, ngjitësi i lagësht i aplikuar duhet të spërkatet deri në tepri me kuarc menjëherë pas aplikimit.		
Rrjedha e varjes	Pa rrjedhje deri në 10 mm trashësi mbi sipërfaqe vertikale	(EN 1799)	
Temperatura e produktit	+10 °C min. / +30 °C max.		
Temperatura e mjedisit	+10 °C min. / +30 °C max.		
Pika e vesës	Kujdes kondensimin. Temperatura e nënshtresës gjatë aplikimit duhet të jetë të paktën 3 °C mbi pikën e vesës.		
Temperatura e nënshtresës	+10 °C min. / +30 °C max.		
Lagështia e përmbajtur e nënshtresës	Nënshtresa duhet të jetë e thatë ose e lagësht mat (pa pellg uji) Lyni nënshtresën me ngjitësin duke përdorur një furçë		
Koha e punueshmërisë	Kohë punueshmërie (200 g)	Temperatura	Koha e punueshmërisë (EN ISO 9514)
		+10 °C	~120 minuta
		+23 °C	~80 minuta
		+35 °C	~42 minuta
		+40 °C	~30 minuta
	Vlera të matura në kushte adiabatike Koha e punueshmërisë fillon kur përbërësit A+B përzihen. Është e shkurtër në temperatura të larta dhe më e gjatë në temperatura të ulëta. Për të përfutur punueshmëri më të gjatë në temperatura të larta, ngjitësi i përzierë mund të ndahet në sasi më të vogla. Sa më e madhe të jetë sasia e përzierë, aq më e shkurtër është koha e punueshmërisë. Për të përfutur kohë më të gjatë punueshmërie në temperatura të larta, adezivi i përzierë mund të ndahet në pjesë më të vogla. Një metodë tjetër është ftohja e Përbërësve A+B përpara përzjerjes (jo nën +5 °C).		
Koha e pritjes / mbiveshja	Sikadur®-31 EF mund të mbivishet me një veshje epokside kompatibël Sika® kur ngjitsi të jetë fortësuar.		

UDHËZIME APLIKIMI

kontaminues tjetër sipërfaqeje që mund të ndikojë ndërkapjen e ngjitësit.

CILËSIA E NËNSHTRESËS

Beton / mure / llaç / gur

Betoni dhe llaçi duhet të jenë të moshës të paktën 3–6 javësh.

Sipërfaqet e nënshtresave duhet të jenë të qëndrueshme, të pastra, të thata ose të lagështa mat, pa ujë të mbledhur, akull, pislleqe, vaj, graso, kore çimentoje, efloreshencë, trajtime të vjetra sipërfaqesh, të gjitha grimcat e lira dhe çdo

Fleta e të dhënave të produktit

Sikadur®-31 EF

Korrik 2020, Botimi 02.01

020204030010000144

BUILDING TRUST



Çeliku

Sipërfaqet duhet të jenë të pastra, të thata, pa vaj, graso, veshje, ndryshk, smërç, grimca të lira dhe ndotës të tjerë të sipërfaqes që mund të ndikojnë në ndërkapjen e ngjitësit.

Druri

Sipërfaqet e nënshtresave duhet të jenë të pastra, të thata, pa vaj, graso, veshje, ndryshk, smërç, grimca të lira dhe ndotës të tjerë të sipërfaqes që mund të ndikojnë në ndërkapjen e ngjitësit.

Poliester / epoksid / qeramika

Sipërfaqet duhet të jenë të pastra, të thata, pa vaj, graso dhe çdo kontaminues tjetër sipërfaqeje që mund të ndikojë ndërkapjen e ngjitësit.

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Beton / mure / llaç / gur

Nënshtresat duhet të përgatiten mekanikisht me pastrim me rrymë abrazive, pistoletë me gjemba (needle gunning), light scabbling, bush hammering, bluarje ose pajisje tjetër të përshtatshme për të arritur një profil sipërfaqeje me teksturë të hapur dhe me aftësi kapëse.

Çeliku

Sipërfaqet duhet të përgatiten mekanikisht me pastrim me rrymë abrazive, bluarje, furçë teli rrotulluese ose pajisje tjetër të përshtatshme për të arritur një finiturë metali të shkëlqyeshëm me një profil sipërfaqeje i cili plotëson kërkesën për rezistencë të nevojshme të ndërkapjes në tërheqje. Të shmangen kushtet e pikës së vesës përpara dhe gjatë aplikimit.

Druri

Sipërfaqet duhet të përgatiten me by zdrugim, smerilizim ose pajisje tjetër të përshtatshme.

Poliester / epoksid

Sipërfaqet duhet të përgatiten me abrazion duke përdorur pajisjen e përshtatshme.

Qeramikat

Sipërfaqet duhet të përgatiten me abrazion duke përdorur pajisjen e përshtatshme. Mos aplikoni mbi nënshtresa të silikonuara.

Të gjitha nënshtresat

I gjithë pluhuri dhe materialet e lira duhet të hiqen plotësisht nga të gjitha sipërfaqet e nënshtresave përpara aplikimit të produktit me pajisje vakuumi / largim pluhuri.

PËRZIERJA

Përpara përzierjes së të gjithë përbërësve, përzieni Përbërësin A (rrëshirën) me një mikser elektrik në shpejtësi të ulët (max. 300 rpm). Shtoni Përbërësin B (forcuesin) tek përbërësi A dhe përzieni Përbërësit A+B vazhdimisht për të paktën 3 minuta derisa të përftohet një miks me ngjyrë të njëtrajtshme me konsistencë të lëmuar. Për të siguruar përzierje të plotë, hidhini materialet brenda një ene të pastër dhe përzieni sërish për ~ 1 minutë. Duhet shmangur përzierja e tepruar për të pakësuar bllokimin e ajrit. Përzieni vetëm njësi të plota. Koha e përzierjes për A+B = 4,0 minuta. Përzieni vetëm atë sasi e cila mund të përdoret brenda kohës së saj të punës.

Fleta e të dhënave të produktit

Sikadur®-31 EF

Korrik 2020, Botimi 02.01

020204030010000144

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Ngjitje

Aplikoni ngjitësin e përzierë mbi sipërfaqet e përgatitura me një shpatull, mallë, mallë të dhembëzuar ose me dorë të veshur me dorezë. Për ngjitje optimale, rekomandohet aplikimi i ngjitësit në të dyja nënshtresat të cilat duhet të ngjiten. Për elemente të rënda të pozicionuara vertikalisht ose mbi tavan, vendosni suport të përkohshëm derisa Sikadur®-31 EF të jetë fortësuar / maturuar plotësisht. Ngurtësimi dhe maturimi varen nga temperatura e ambientit.

Riparim

Aplikoni ngjitësin e përzierë mbi sipërfaqet e përgatitura me një shpatull, mallë ose me dorë të veshur me dorezë. Nëse kërkohet, vendosni përkohësisht kallëp.

Mbushje fugash dhe izolim plasaritjesh

Aplikoni ngjitësin e përzierë mbi sipërfaqet e përgatitura me një shpatull ose mallë.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me Sika® Colma Cleaner menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / maturuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Rrëshirat Sikadur® janë formuluar për të patur zvarrje të ulët nën ngarkesë të përhershme. Megjithatë, për shkak të sjelljes së zvarrjes të të gjitha materialeve polimere nën ngarkesë, kur përdorni ngjitës për aplikime strukturore, ngarkesa strukturore afatgjatë duhet të jetë përlogaritur për zvarrje. Në përgjithësi, ngarkesa strukturore afatgjatë duhet të jetë më e ulët sesa 20-25% e ngarkesës së dështimit. Duhet të këshilloheni me një inxhinier strukturist për përlogatjet e projektimit të aplikimeve specifike strukturore.
- Kur gjatë aplikimit përdoren shumë njësi, mos përzieni njësinë e rredhës derisa e mëparshmeja të jetë përdorur, në mënyrë që kështu të shmanget pakësimi i punueshmërisë
- Për elementet me peshë të rëndë të pozicionuar vertikalisht ose horizontalisht, vendosni suport të përkohshëm

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikadur®-31 EF
Korrik 2020, Botimi 02.01
020204030010000144

Sikadur-31EF-sq-AL-(07-2020)-2-1.pdf

